

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR BASHKËPUNIMIN E ZBATIMIT TË LIGJIT, PËR VENDOSJEN E OFICERIT NDËRLIDHËS TË EUROPOL-IT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Marrëveshja që po paraqitet për ratifikim është iniciuar nga Europol-i, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, nënshkruar, më 9 dhjetor 2013, në Hagë.

Marrëveshja synon vendosjen e oficerit ndërlidhës të Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit (Europol) në vendin tonë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji që propozohet të miratohet është në koherencë të plotë me programin e qeverisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Vendosja e oficerit ndërlidhës të Europol-it në vendin tonë, konkretisht në Zyrën Kombëtare të Europol-i pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, synon të sjellë mbështetje, bashkërendim të veprimeve dhe bashkëpunim në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar, si dhe lehtësim të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Europol-it dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78, 83, 155 të Kushtetutës, në harmoni me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën

e Shqipërisë”, si dhe në kuadër të marrëveshjes për rritjen e bashkëpunimit operacional dhe strategjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), nënshkruar, më 9 dhjetor 2013, në Hagë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it, e cila është miratuar në parim me vendimin nr.403, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar nga palët.

Marrëveshja përbëhet nga 9 nene.

Neni 1 përcakton se palët bien dakord për vendosjen e një ose më shumë oficerëve ndërlidhës të Europol-it në Shqipëri.

Numri i oficerëve ndërlidhës të Europol-it do të dakordësohet paraprakisht ndërmjet palëve.

Neni 2 përcakton detyrat e oficerit ndërlidhës.

Neni 3 përcakton statusin e oficerit ndërlidhës, ku parashikohet se Shqipëria, brenda territorit të saj, do t'i japë zyrtarit ndërlidhës të Europol-it të njëjtat privilegje dhe imunitete si ato të akorduara nga Shqipëria për shtetet anëtare, me gradë të krahasueshme të stafit të misioneve diplomatike të vendosura në Shqipëri.

Neni 4 përcakton metodat e punës, ku parashikohet se gjatë shkëmbimit të informacionit oficeri ndërlidhës i Europol-it do të komunikojë me pikat kombëtare të kontaktit dhe me autoritetet kombëtare kompetente, siç është përcaktuar në marrëveshje ose në ndonjë entitet tjetër specifik brenda Shqipërisë, i dedikuar për këtë qëllim.

Neni 5 parashikon çështjet administrative për vendosjen e zyrës së oficerit ndërlidhës në Shqipëri, si dhe parashikohet përjashtimi nga të gjitha detyrimet doganore, ndalimet dhe kufizimet në importin e eksportin në lidhje me mallrat për përdorim zyrtar.

Neni 6 përcakton mënyrën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përgjegjësi në rast konflikti.

Neni 7 përcakton modalitetet për ndryshimet që mund t'i bëhen marrëveshjes.

Neni 8 përcakton modalitetet për përfundimin e marrëveshjes nga palët.

Neni 9 përcakton modalitetet për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit).

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Brendshme.

Nevoja për ratifikimin me ligj të marrëveshjes lind si pasojë e përfitimit të privilegjeve dhe imuniteteve të oficerit ndërlidhës të Europol-it në vendin tonë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj projekt marrëveshjeje (të parashikuara në nenin 5.1 të saj) do të mbulohen nga programi buxhetor i Policisë së Shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE